

VENDIM
Nr. 130, datë 3.12.2014

MBI PROCEDURAT PËRBLERJEN
E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË
SISTEMIN E SHPËRNDARJES NGA OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE SHA
(OSHEE SHA)

Në mbështetje të neneve; 8, pika 2, germa "P"; dhe 9, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr. 98, datë 27.10.2014, "Për përfundimin e administrimit të përkohshëm të shoqërisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrikesh.a.(OSHEE), Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.12.2014, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi procedurat për blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrikesh.a.(OSHEE sh.a.),

konstatoi se,

- Me vendimin nr. 96, datë 27.10.2014, ERE licencoi në aktivitetin e shpërndarjes të energjisë elektrike shoqërinë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrikesh.a.(OSHEE sh.a.) për një afat 30-vjeçar.

- Me vendimin nr. 97, datë 27.10.2014, ERE licencoi në aktivitetin e furnizuesit publik me pakicë të Energjisë Elektrike shoqërinë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.)

- Me vendimin nr. 98, datë 27.10.2014, ERE vendosi përfundimin e administrimit të përkohshëm të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrikesh.a.(OSHEE sh.a.), sipas vendimit të Bordit të Komisionerëve nr. 5, datë 21.1.2013.

Në bazë të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, ERE përcakton procedurat e shitjes, blerjes dhe shkëmbimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrikesh.a.(OSHEE), për nevojat e mbulimit të plotë të humbjeve në sistemin e shpërndarjes, të realizojë blerjet e energjisë elektrike në përputhje me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s me nr. 30, datë 23.3.2011, "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga KESH sh.a.".

2. Ky vendim është objekt rishikimi me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë OSHEE sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti